LIGJ
Nr.10 406, datë 31.3.2011

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "MARRËVESHJEN NDËRKOMBËTARE TË LËNDËS DRUSORE TROPIKALE, 2006"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Marrëveshjen ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale, 2006".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6970, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONFERENCË
E KOMBEVE TË BASHKUARA
MBI TREGTINË DHE ZHVILLIMIN

Konferencë e Kombeve të Bashkuara për bisedimet mbi një marrëveshje pasuese për marrëveshjen ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale të vitit 1994,

Pjesa e katërt
Gjenevë, 16-27 janar 2006
Çështja në agjendë 7

MARRËVESHJE
NDËRKOMBËTARE E LËNDËS DRUSORE TROPIKALE, 2006

PREAMBULË

Palët e kësaj Marrëveshjeje:

a) Duke kujtuar Deklaratën dhe Programin e Veprimit mbi ngritjen e një rendi ekonomik ndërkombëtar të ri; Programin e Integruar për Mallrat; Partneritetin e Ri për Zhvillimin; dhe Frymën e San Paulos dhe Konsensusin e San Paolos, të miratuar nga UNCTAD XI;

b) Duke kujtuar gjithashtu Marrëveshjen ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale, 1983, dhe Marrëveshjen ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale, 1994, dhe duke njohur punën e Organizatës Ndërkombëtare të Lëndës Drusore Tropikale dhe arritjet e saj qysh nga fillimi, duke përfshirë një strategji për arritjen e tregtisë ndërkombëtare në lëndën drusore tropikale nga

burime të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme;

c) Duke kujtuar më tej Deklaratën e Johanesburgut dhe Planin e Zbatimit sipas miratimit nga Samiti Botëror i Zhvillimit të Qëndrueshëm të shtatorit 2002, Forumin e Kombeve të Bashkuara mbi Pyjet, të themeluar në tetor 2000 dhe Krijimin e Asociuar të Partneritetit Bashkëpunues për Pyjet, anëtare e së cilës është Organizata Ndërkombëtare e Lëndës Drusore Tropikale, si dhe Deklaratën e Rios për ambientin dhe zhvillimin, Deklarimin Ligjërisht jo të Detyrueshëm të Autoritetit të Parimeve për një konsensus global mbi menaxhimin, konservimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha tipave të pyjeve dhe kapitujt përkatës të Agjendës 21 siç është miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ambientin dhe Zhvillimin, e qershorit 1992, Konventën kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimin klimaterik, Konventën e Kombeve të Bashkuara për diversitetin biologjik dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër desertifikimit;

d) Duke njohur që shtetet, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, kanë të drejtën sovrane për të shfrytëzuar burimet e tyre në pajtim me politikat e tyre ambientaliste dhe kanë përgjegjësinë për të siguruar që aktivitetet brenda juridiksionit dhe kontrollit të tyre nuk shkaktojnë dëm në ambientin e shteteve të tjera ose në zonave përtej kufijve të juridiksionit kombëtar, sipas parashikimit në parimin 1(a) të Deklarimit të Parimeve Ligjërisht jo të Detyrueshme për një konsensus global mbi menaxhimin, konservimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha tipave të pyjeve;

e) Duke njohur rëndësinë e lëndës drusore dhe tregtinë përkatëse për ekonomitë e vendeve prodhuese të lëndës drusore;

f) Duke njohur gjithashtu rëndësinë e përfitimeve të shumëfishta ekonomike, ambientaliste dhe sociale që jepen nga pyjet, duke përfshirë produktet e lëndëve drusore dhe jodrusore të pyjeve dhe shërbimet ambientaliste, në kontekstin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në nivelet lokale, kombëtare dhe globale dhe kontributin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbutjen e varfërisë, dhe arritjen e qëllimeve të zhvillimit, të rëna dakord ndërkombëtarisht, duke përfshirë ato që gjenden në Deklaratën e Mijëvjeçarit;

g) Duke njohur më tej nevojën për të nxitur dhe zbatuar kritere dhe tregues të krahasueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve si mjete të rëndësishme për të gjithë anëtarët, për të vlerësuar, monitoruar dhe nxitur progresin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve të tyre;

h) Duke marrë parasysh lidhjen e tregtisë të lëndës drusore tropikale dhe tregun ndërkombëtar të lëndës drusore dhe ekonominë më të gjerë globale, dhe nevojën për një këndvështrim global, me qëllim që të përmirësohet transparenca në tregtinë ndërkombëtare të lëndës drusore;

i) Duke riafirmuar përkushtimin e tyre për të ecur sa më shpejt të jetë e mundur drejt arritjes së eksporteve të lëndës drusore tropikale dhe produkteve të lëndës drusore nga burime të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme (Objektivi ITTO 2000) dhe duke kujtuar themelimin e Fondit të Partneritetit Bali;

j) Duke kujtuar përkushtimin e shprehur nga anëtarët konsumatorë në janar 1994 për të ruajtur ose arritur menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve të tyre;

k) Duke vënë re rolin e qeverisjes së mirë, masat e qarta për posedimin e tokës dhe bashkërendimin ndërsektorial në arritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe eksporte të lëndës drusore nga burime të ligjshme;

l) Duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve, organizatave ndërkombëtare, sektorit privat dhe shoqërisë civile, duke përfshirë komunitetet autoktone dhe lokale, dhe aktorë të tjerë në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;

m) Duke njohur gjithashtu rëndësinë e këtij bashkëpunimi për përmirësimin e zbatimit të së drejtës së pyjeve dhe nxitur tregtinë me lëndë drusore të vjelë ligjërisht;

n) Duke vënë re që rritja e kapacitetit të komuniteteve autoktone dhe lokale të

mbështetura mbi pyjet, përfshijnë ato që janë pronarë dhe menaxherë të pyjeve, mund të kontribuojë për arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje;

o) Duke vënë re gjithashtu nevojën e përmirësimit të standardit të jetesës dhe të kushteve të punës brenda sektorit të pyjeve, duke marrë parasysh parimet përkatëse të njohura ndërkombëtarisht për këto çështje, konventat dhe instrumentet përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;

p) Duke vënë re që lënda drusore është një lëndë e parë efektive energjie, e rinovueshme dhe jo e dëmshme për ambientin, krahasuar me produktet konkurruese;

q) Duke njohur nevojën për investime në rritje për menaxhimin e qëndrueshëm të ambientit, duke përfshirë ato nëpërmjet riinvestimit të të ardhurave të gjeneruara nga pyjet, duke përfshirë tregtinë në lidhje me lëndën drusore;

r) Duke njohur gjithashtu përfitimet e çmimeve të tregut që reflektojnë koston e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;

s) Duke njohur më tej nevojën për burime më të mëdha dhe të parashikueshme financiare nga një komunitet i gjerë donatorësh për të arritur objektivat e kësaj Marrëveshjeje;

t) Duke vënë re nevojat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara, prodhuese të lëndës drusore tropikale,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

KAPITULLI I
OBJEKTIVAT

Neni 1
Objektivat

Objektivat e Marrëveshjes ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale, 2006 (këtu quhet "kjo Marrëveshje") synojnë të nxisin zgjerimin dhe diversifikimin e tregtisë ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale nga pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe të vjelë në mënyrë të ligjshme dhe të nxisin menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve që prodhojnë lëndë drusore tropikale, nëpërmjet:

a) Sigurimit të një kuadri të efektshëm për konsultimin, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e politikave ndërmjet të gjithë anëtarëve në lidhje me të gjitha aspektet përkatëse të ekonomisë botërore të lëndës drusore;

b) Sigurimit të një forumi konsultimi për nxitjen e praktikave të tregtisë së lëndës drusore pa diskriminim;

c) Kontribuimit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbutjen e varfërisë;

d) Rritjes së kapacitetit të anëtarëve për zbatimin e strategjive për arritjen e eksporteve të lëndës drusore tropikale dhe produkteve të lëndës drusore nga burimet e menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme;

e) Nxitjes së një koncepti më të drejtë të kushteve strukturore në tregjet ndërkombëtare, duke përfshirë tendencat afatgjata në konsum dhe prodhim, faktorëve që ndikojnë në hyrjen në treg, preferencave të konsumatorëve dhe çmimeve, dhe kushteve që çojnë në çmime që reflektojnë koston e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;

f) Nxitjes dhe mbështetjes së kërkimit dhe zhvillimit, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të pyjeve dhe efikasitetit të përdorimit të drurit dhe konkurrueshmërisë së produkteve të drurit në lidhje me materiale të tjera, si dhe rritjes së kapacitetit për të konservuar dhe shtuar vlerat e tjera të pyjeve në pyjet tropikale për prodhimin e lëndës drusore;

g) Zhvillimit dhe kontribuimit drejt mekanizmave për sigurimin e burimeve financiare të reja dhe shtesë, me qëllim nxitjen e përshtatshmërisë dhe parashikueshmërisë së fondeve dhe ekspertizës së nevojshme për të rritur kapacitetin e anëtarëve prodhues për të arritur objektivat e

kësaj marrëveshjeje;

h) Përmirësimit të informacionit për tregun dhe inkurajimit të shkëmbimit të informacionit mbi tregun ndërkombëtar të lëndës drusore, me qëllim sigurimin e një transparence më të madhe dhe informimi më të mirë për tregjet dhe tendencat e tregjeve, duke përfshirë mbledhjen, përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave në lidhje me tregtinë, duke përfshirë të dhënat në lidhje me speciet që tregtohen;

i) Nxitjes së përpunimit në rritje dhe të mëtejshëm të lëndës drusore tropikale nga burime të qëndrueshme në vendet anëtare prodhues, me qëllim nxitjen e industrializimit të tyre dhe në këtë mënyrë rritjen e mundësive të tyre të punësimit dhe fitimeve të eksportit;

j) Inkurajimit të anëtarëve për të mbështetur dhe zhvilluar ripyllëzimin për lëndën drusore tropikale, si dhe rehabilitimin dhe restaurimin e tokës së degraduar të pyjeve, duke marrë si duhet parasysh interesat e komuniteteve lokale që varen nga burimet e pyjeve;

k) Përmirësimit të tregtimit dhe shpërndarjes së lëndës drusore tropikale dhe eksporteve të produkteve të lëndës drusore nga burimet e menaxhuara dhe vjelë në mënyrë të ligjshme dhe që tregtohen ligjërisht, duke përfshirë nxitjen e ndërgjegjësimit të konsumatorit;

l) Fuqizimit të kapacitetit të anëtarëve për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave në tregtinë e tyre të lëndës drusore dhe informacionin mbi menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve tropikale të tyre;

m) Inkurajimit të anëtarëve për të zhvilluar politika kombëtare që synojnë përdorim të qëndrueshëm dhe konservimin e pyjeve që prodhojnë lëndë drusore, dhe ruajtjes së balancës ekologjike, në kontekstin e tregtisë së lëndës drusore tropikale;

n) Forcimit të kapaciteteve të anëtarëve për të përmirësuar zbatimin e së drejtës dhe qeverisjes së pyjeve, dhe trajtuar prerjet e paligjshme si dhe tregtinë përkatëse me lëndën drusore tropikale;

o) Inkurajimit të shkëmbimit të informacionit për një koncept më të drejtë të mekanizmave vullnetare, si, ndër të tjera, certifikimit, për nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve tropikale dhe ndihmesës së anëtarëve në përpjekjet e tyre në këtë sferë;

p) Nxitjes së mundësimit dhe transferimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit teknik për të zbatuar objektivat e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë termat dhe kushtet koncesionare dhe preferenciale, siç bihet dakord bashkërisht;

q) Nxitjes së një koncepti më të mirë për kontributin e produkteve pyjore jodrusore dhe shërbimeve ambientaliste për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve tropikale, me qëllim rritjen e kapacitetit të anëtarëve për të zhvilluar strategji për të forcuar këto kontribute në kontekstin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe bashkëpunimit me institucionet dhe proceset përkatëse për këtë qëllim;

r) Inkurajimit të anëtarëve për njohjen e rolit të komuniteteve autoktone dhe lokale të varura nga pyjet në arritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe zhvillimit të strategjive për rritjen e kapacitetit të këtyre komuniteteve për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme pyjet që prodhojnë lëndë drusore tropikale; dhe

s) Identifikimit dhe trajtimit të çështjeve përkatëse të reja dhe në zhvillim.

KAPITULLI II
PËRKUFIZIME

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Lëndë drusore tropikale” është dru tropikal për përdorim industrial, që rritet ose prodhohet në vendet që gjenden në Tropikun e Gaforres dhe Tropikun e Bricjapit. Termi përfshin trupat, drurin e sharruar, fletët e rimesos dhe kompensatën.

2. “Menaxhim i qëndrueshëm i pyjeve” kuptohet sipas dokumenteve të politikave përkatëse dhe udhëzimeve teknike të Organizatës.

3. “Anëtar” është një qeveri, Komuniteti Europian ose një organizatë ndërqeveritare e përmendur në nenin 5, që ka rënë dakord t’i nënshtrohet kësaj Konvente pavarësisht nëse është në fuqi përkohësisht apo përfundimisht.

4. “Anëtar prodhues” është një anëtar që gjendet ndërmjet Tropikut të Gaforres dhe Tropikut të Bricjapit me burime pylli tropikal dhe/ose një eksportues neto të lëndës drusore tropikale në lidhje me volumin që janë renditur në aneksin A dhe që bëhen pjesë e kësaj Marrëveshjeje, ose një anëtar me burime pyjesh tropikale dhe/ose një eksportues neto të lëndës drusore tropikale në lidhje me volumin që nuk është renditur dhe që bëhet palë në këtë Marrëveshje dhe që Këshilli, me pëlqimin e atij anëtari, e deklaron të jetë anëtar prodhues;

5. “Anëtar konsumator” do të thotë çdo anëtar që është importues i lëndës drusore tropikale të renditur në aneksin B që bëhet palë në këtë Marrëveshje ose çdo anëtar që është importues i lëndës drusore tropikale që nuk është i renditur, i cili bëhet palë në këtë Marrëveshje dhe që Këshilli, me pëlqimin e atij anëtari, e deklaron atë anëtar konsumator.

6. “Organizatë” është Organizata Ndërkombëtare e Lëndës Drusore Tropikale e themeluar në pajtim me nenin 3.

7. “Këshill” është Këshilli Ndërkombëtar i Lëndës Drusore Tropikale i themeluar në pajtim me nenin 6.

8. “Votim i veçantë” është një votë që kërkon të paktën dy të tretat e votave të hedhura nga anëtarët prodhues të pranishëm dhe që votojnë dhe të paktën 60 për qind e votave të hedhura nga anëtarët konsumatorë të pranishëm dhe që votojnë, të numëruar veçmas, me kusht që këto vota të hidhen nga të paktën gjysma e anëtarëve prodhues të pranishëm dhe që votojnë dhe të paktën gjysma e anëtarëve konsumatorë të pranishëm dhe që votojnë.

9. “Votim i shumicës së thjeshtë të shpërndarë” është një votim që kërkon më shumë se gjysmën e votave të hedhura nga anëtarët prodhues të pranishëm dhe që votojnë dhe më shumë se gjysma e votave të hedhura nga anëtarët konsumatorë të pranishëm dhe që votojnë, të numëruar veçmas.

10. “Dyvjeçar financiar” është periudha financiare nga 1 janari i një viti deri më 31 dhjetor të vitit pasues.

11. “Monedhë lirisht e konvertueshme” është euro, jeni japonez, stërlina britanike, franga zvicerane, dollari i Shteteve të Bashkuara dhe çdo monedhë tjetër që caktohet herë pas here nga një organizatë ndërkombëtare kompetente monetare që faktikisht përdoret gjerësisht për të bërë pagesat për transaksionet ndërkombëtare dhe që tregtohet gjerësisht në tregjet kryesore të këmbimit.

12. Për qëllimet e përllogaritjes së shpërndarjes së votave sipas nenit 10, paragrafi 2(b), “burimet e pyjeve tropikale” janë pyjet e mbyllura natyrale dhe plantacionet e pyjeve që gjenden ndërmjet Tropikut të Gaforres dhe Tropikut të Bricjapit.

KAPITULLI III
ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 3
Qendra dhe struktura e Organizatës Ndërkombëtare të Lëndës Drusore Tropikale

1. Organizata Ndërkombëtare e Lëndës Drusore Tropikale e themeluar me Marrëveshjen ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale të vitit 1983 do të vazhdojë të ekzistojë për qëllimet e administrimit të dispozitave dhe mbikëqyrjes së zbatimit ë kësaj Marrëveshjeje.

2. Organizata funksionon nëpërmjet Këshillit të themeluar sipas nenit 6, komiteteve dhe organeve të tjera të varura të përmendura në nenin 26 dhe drejtorit ekzekutiv dhe personelit.

3. Qendra e Organizatës gjendet gjithmonë në territorin e një anëtari.

4. Qendra e Organizatës gjendet në Yokohama, përveç rasteve kur Këshilli, nëpërmjet një votimi të veçantë në pajtim me nenin 12, vendos ndryshe.

5. Zyrat rajonale të Organizatës mund të themelohen nëse Këshilli e vendos këtë me votim të veçantë në pajtim me nenin 12.

Neni 4

Anëtarësia në Organizatë

Ka dy kategori anëtarësie në Organizatë, që janë:

a) prodhues, dhe

b) konsumator.

Neni 5

Anëtarësia nga organizatat ndërqeveritare

1. Çdo referencë në këtë Marrëveshje tek "Qeveritë" interpretohet sikur përfshin Komunitetin Europian dhe organizatat e tjera ndërqeveritare që kanë përgjegjësi të krahasueshme në lidhje me bisedimet, përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, veçanërisht marrëveshjet për mallrat. Për pasojë, çdo referencë në këtë Marrëveshje ndaj nënshkrimit, ratifikimit, pranimit apo miratimit, ose njoftimi i zbatimit të përkohshëm ose aderimi, në rastin e këtyre organizatave, interpretohet sikur përfshin referencën ndaj nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit ose njoftimi i zbatimit të përkohshëm apo aderimit nga këto organizata.

2. Në rastin e votimit për çështje brenda kompetencës së tyre, Komuniteti Europian dhe organizatat e tjera ndërqeveritare të përmendura në paragrafin 1 votojnë me një numër votash të barabartë me numrin e përgjithshëm të votave që u përkasin shteteve të tyre anëtare të cilat janë palë në Marrëveshje në pajtim me nenin 10. Në këto raste, shtetet anëtare të këtyre organizatave nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre individuale të votimit.

KAPITULLI IV

KËSHILLI NDËRKOMBËTAR PËR LËNDËN DRUSORE TROPIKALE

Neni 6

Përbërja e Këshillit Ndërkombëtar të Lëndës Drusore Tropikale

1. Autoriteti më i lartë i Organizatës është Këshilli Ndërkombëtar i Lëndës Drusore Tropikale që përbëhet nga të gjithë anëtarët e Organizatës.

2. Secili anëtar përfaqësohet në Këshill nga një përfaqësues dhe mund të caktojë zëvendës ose këshilltarë për të ndjekur sesionet e Këshillit.

3. Një zëvendës autorizohet të veprojë dhe votojë në emër të përfaqësuesit gjatë mungesës së këtij të fundit ose në rrethana të veçanta.

Neni 7

Kompetencat dhe funksionet e Këshillit

Këshilli ushtron të gjitha ato kompetenca dhe kryen ose merr masa për kryerjen e të gjitha atyre funksioneve që janë të nevojshme për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Në veçanti, ai:

a) me votim të veçantë, në pajtim me nenin 12, miraton ato rregulla dhe rregullore që janë të nevojshme për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe që janë në pajtim me të, duke

përfshirë rregullat e veta procedurale dhe rregullat financiare dhe rregullat e personelit të Organizatës. Këto rregulla dhe rregullore financiare, ndër të tjera, rregullojnë marrjen dhe shpenzimin e fondeve në llogaritë e hapura sipas nenit 18. Këshilli, në rregullat e veta procedurale, mund të parashikojë një procedurë, nëpërmjet së cilës mund të vendosë për çështje të veçanta pa u mbledhur;

b) merr ato vendime që janë të nevojshme për të siguruar funksionimin dhe operimin efektiv dhe efikas të Organizatës; dhe

c) mban ato regjistra që kërkohen për përmbushjen e funksioneve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit

1. Këshilli zgjedh për çdo vit kalendarik një kryetar dhe një zëvendëskryetar, pagat e të cilëve nuk paguhen nga Organizata.

2. Kryetari dhe Zëvendëskryetari zgjidhen një nga përfaqësuesit e anëtarëve prodhues dhe tjetri nga përfaqësuesit e anëtarëve konsumatorë.

3. Këto poste shkëmbehen çdo vit ndërmjet të dy kategorive të anëtarëve, me kusht që kjo nuk ndalon rizgjedhjen e njërit ose të dyve në rrethana të veçanta.

4. Në mungesë të përkohshme të Kryetarit, Zëvendëskryetari ushtron funksionet e kryetarit. Në mungesë të përkohshme të të dyve, Kryetari dhe Zëvendëskryetari, ose në mungesë të njërit apo të të dyve prej tyre për pjesën e mbetur të mandatit për të cilin janë zgjedhur, Këshilli mund të zgjedhë punonjës të rinj nga përfaqësuesit e anëtarëve prodhues dhe/ose nga anëtarët e anëtarëve konsumatorë, sipas rastit, me bazë të përkohshme ose për pjesën tjetër të mandatit për të cilin ishte ose ishin zgjedhur pararendësi ose pararendësit.

Neni 9

Sesionet e Këshillit

1. Si rregull i përgjithshëm, Këshilli mban të paktën një sesion të zakonshëm në vit.

2. Këshilli mblidhet në sesion të veçantë, kurdoherë që ai e vendos këtë ose me kërkesë të çdo anëtari ose të Drejtorit Ekzekutiv, në marrëveshje me kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e Këshillit, dhe:

a) një shumicë të anëtarëve prodhues ose një shumicë të anëtarëve konsumatorë; ose

b) një shumicë të anëtarëve.

3. Sesionet e Këshillit mbahen në qendrën e Organizatës, përveç rasteve kur Këshilli, me votim të veçantë, në pajtim me nenin 12, vendos ndryshe. Në këtë kuptim, Këshilli kërkon të thërresë sesione të tjera të Këshillit jashtë qendrës, mundësisht në një vend prodhues.

4. Në shqyrtimin e shpeshtësisë dhe vendndodhjes së sesioneve, këshilli kërkon të sigurojë disponibilitetin e fondeve të mjaftueshme.

5. Njoftimi për çdo sesion dhe agjendën e këtyre sesioneve u komunikohet anëtarëve të Drejtorit Ekzekutiv të paktën gjashtë javë paraprakisht, përveç rasteve të emergjencës, kur njoftimi u komunikohet të paktën shtatë ditë paraprakisht.

Neni 10

Shpërndarja e votave

1. Anëtarët prodhues kanë së bashku 1000 vota dhe anëtarët konsumatorë kanë së bashku 1000 vota.

2. Votat e anëtarëve prodhues shpërndahen si më poshtë:

a) Katërqind vota u shpërndahen në mënyrë të barabartë tre rajoneve prodhuese të Afrikës, Azi-Paqësorit dhe Amerikës Latine dhe Karaibeve. Këto vota të dhëna në këtë mënyrë

për secilën prej këtyre rajoneve shpërndahen më tej në mënyrë të barabartë ndërmjet anëtarëve prodhues të atij rajoni;

b) Treqind vota u shpërndahen anëtarëve prodhues në pajtim me pjesët e tyre përkatëse në burimet e përgjithshme të pyjeve tropikale të të gjithë anëtarëve prodhues; dhe

(c) Treqind vota u shpërndahen anëtarëve prodhues në raport me mesataren e vlerave të eksporteve të tyre përkatëse neto të lëndës drusore tropikale gjatë periudhës së fundit trevjeçare për të cilën ofrohen shifrat përfundimtare.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, votat e përgjithshme që u jepen anëtarëve prodhues nga rajoni i Afrikës, të llogaritura në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, u shpërndahen në mënyrë të barabartë të gjithë anëtarëve prodhues nga rajoni i Afrikës. Nëse ka vota të mbetura, secila prej këtyre votave i jepet një anëtari prodhues nga rajoni i Afrikës: e para tek anëtari prodhues të cilit i jepet numri më i madh i votave të llogaritura në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, e dyta anëtarit prodhues që i jepet numri i dytë më i madh i votave dhe kështu me radhë deri sa të shpërndahen të gjitha votat e mbetura.

4. Në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, votat e anëtarëve konsumatorë shpërndahen si më poshtë: secili anëtar konsumator ka 10 vota fillestare; votat e mbetura shpërndahen ndërmjet anëtarëve konsumatorë në raport me volumin e tyre mesatar të importeve të tyre përkatëse neto të lëndës drusore tropikale gjatë periudhës pesëvjeçare që fillon gjashtë vite kalendarike para shpërndarjes së votave.

5. Votat e dhëna një anëtari konsumator për një dyvjeçar të caktuar nuk kalon 5 për qind të votave dhe mbi votat e dhëna atij anëtari për dyvjeçarin e kaluar. Votat e mbetura do të rishpërndahen ndërmjet anëtarëve konsumatorë në raport me volumin mesatar të importeve të tyre përkatëse të lëndës drusore tropikale gjatë periudhës pesëvjeçare që fillon gjashtë vite kalendarike para shpërndarjes së votave.

6. Këshilli, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, mund të rregullojë përqindjen minimale të kërkuar për një votim të veçantë nga anëtarët konsumatorë nëse kjo konsiderohet e nevojshme.

7. Këshilli i shpërndan votat për çdo dyvjeçar financiar në fillim të sesionit të tij të parë për atë dyvjeçar në pajtim me dispozitat e këtij neni. Kjo shpërndarje mbetet në fuqi për pjesën e mbetur të dyvjeçarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 8 të këtij neni.

8. Kurdoherë që ndryshon anëtarësia e Organizatës ose kur një anëtari i pezullohen ose i rijepen të drejtat e votimit në bazë të një dispozite të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli rishpërndan votat brenda kategorisë ose kategorive të anëtarëve në pajtim me dispozitat e këtij neni. Këshilli, në këtë rast, vendos kur hyn në fuqi një rishpërndarje e tillë.

9. Nuk ka vota të ndara.

Neni 11

Procedura e votimit të Këshillit

1. Çdo anëtar ka të drejtë të hedhë numrin votave që ka dhe asnjë anëtar nuk ka të drejtë të ndajë votat e tij. Megjithatë, një anëtar mund të votojë ndryshe nga këto vota për çdo votë që autorizohet të hidhet në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

2. Me njoftim me shkrim drejtuar Kryetarit të Këshillit, çdo anëtar prodhues mund të autorizojë, nën përgjegjësinë e tij, çdo anëtar tjetër prodhues, dhe çdo anëtar konsumator mund të autorizojë, nën përgjegjësinë e tij, çdo anëtar tjetër konsumator, të përfaqësojë interesat e tij dhe të hedhë votat në çdo mbledhje të Këshillit.

3. Në rastin e abstenimit, një anëtar konsiderohet të mos ketë hedhur votat e tij.

Neni 12

Vendimet dhe rekomandimet e Këshillit

1. Këshilli përpiqet të marrë të gjitha vendimet dhe t'i bëjë të gjitha rekomandimet me konsensus.

2. Nëse konsensusi nuk mund të arrihet, Këshilli i merr të gjitha vendimet dhe i bën të gjitha rekomandimet me votën e shumicës së thjeshtë të shpërndarë, përveç rasteve kur kjo Marrëveshje parashikon një votim të veçantë.

3. Nëse një anëtar zbaton dispozitat e nenit 11, paragrafi 2, dhe votat e tij hidhen në një takim të këshillit, ky anëtar, për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, konsiderohet të jetë i pranishëm dhe që voton.

Neni 13
Kuorumi i Këshillit

1. Kuorumi për çdo mbledhje të këshillit është prania e një shumice të anëtarëve të secilës kategori të përmendur në nenin 4, me kusht që këta anëtarë të kenë të paktën dy të tretat e votave të përgjithshme në kategorinë e tyre përkatëse.

2. Nëse nuk ka kuorum në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni në ditën e caktuar për mbledhjen dhe në ditën pasuese, kuorumi në ditën pasuese të sesionit do të jetë prania e shumicës së anëtarëve për secilën kategori të përmendur në nenin 4, me kusht që këta anëtarë të kenë shumicën e votave të përgjithshme në kategoritë e tyre përkatëse.

3. Përfaqësimi në pajtim me nenin 11, paragrafi 2, konsiderohet si prani.

Neni 14
Drejtori Ekzekutiv dhe personeli

1. Këshilli, me votim të veçantë sipas nenit 12, emëron Drejtorin Ekzekutiv.

2. Termat dhe kushtet e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv caktohen nga Këshilli.

3. Drejtori Ekzekutiv është kryepunonjësi administrativ i organizatës dhe është përgjegjës para këshillit për administrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në pajtim me vendimet e Këshillit.

4. Drejtori Ekzekutiv emëron personelin në pajtim me rregulloren që vendoset nga këshilli. Personeli përgjigjet para Drejtorit Ekzekutiv.

5. As Drejtori Ekzekutiv, dhe asnjë anëtar personeli nuk ka interes financiar në industrinë ose tregtinë e lëndës drusore apo aktivitetet përkatëse tregtare.

6. Në përmbushje të detyrave të tyre, Drejtori Ekzekutiv dhe personeli nuk kërkojnë apo pranojnë udhëzime nga asnjë anëtar ose autoritet nga jashtë Organizatës. Ata nuk kryejnë asnjë veprim që mund të kishte efekt negativ në pozicionet e tyre si punonjës ndërkombëtarë përfundimisht përgjegjës para Këshillit. Çdo anëtar respekton karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësive të Drejtorit Ekzekutiv dhe personelit dhe nuk kërkon të ndikojë tek atë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre.

Neni 15
Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me organizatat e tjera

1. Për arritjen e objektivave të Marrëveshjes, Këshilli merr masat e përshtatshme për konsultimet dhe bashkëpuniminin me Kombet e Bashkuara dhe organet e tij dhe agjencitë e specializuara, duke përfshirë Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) dhe organizatat dhe institucionet e tjera përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe sektorin privat, organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile.

2. Organizata, në masën më të madhe të mundur, përdor pajisjet, shërbimet dhe ekspertizën e organizatave ndërqeveritare, qeveritare dhe joqeveritare, të shoqërisë civile dhe të sektorit privat, me qëllim që të mënjanojë publikimin e përpjekjeve për arritjen e objektivave të

kësaj Marrëveshjeje dhe për të rritur plotshmërinë dhe efiçencën e aktiviteteve të tyre.

3. Organizata përdor plotësisht mjetet e Fondit të Përbashkët për Mallrat.

Neni 16
Pranimi i vëzhguesve

Këshilli mund të ftojë çdo shtet anëtar ose vëzhgues të Kombeve të Bashkuara që nuk është palë në këtë marrëveshje, ose çdo organizatë që përmendet në nenin 15 të interesuar në aktivitetet e organizatës, për të marrë pjesë si vëzhgues të sesioneve të Këshillit.

KAPITULLI V
PRIVILEGJET DHE IMUNITETET

Neni 17
Privilegjet dhe Imunitetet

1. Organizata ka personalitet juridik. Ajo ka veçanërisht zotësinë për të lidhur kontrata, për të përftuar dhe disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të filloje çështje gjyqësore.

2. Statusi, privilegjet dhe imunitetet e Organizatës, të Drejtorit të saj Ekzekutiv, të personelit dhe të ekspertëve të saj, dhe të përfaqësuesve të anëtarëve në territorin e Japonisë vazhdojnë të rregullohen nga Marrëveshja për Qendrën ndërmjet Qeverisë së Japonisë dhe Organizatës Ndërkombëtare për Lëndën Drusore Tropikale të nënshkruar në Tokio më 27 shkurt 1988, me ato ndryshime që mund të jenë të nevojshme për funksionimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje.

3. Organizata mund të përfundojë, me një ose më shumë vende, marrëveshje që duhet të aprovohen nga Këshilli në lidhje me atë zotësi, privilegje dhe imunitete që mund të jenë të nevojshme për funksionimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje.

4. Nëse qendra e Organizatës transferohet në një vend tjetër, anëtari në fjalë, sa më shpejt të jetë e mundur, lidh një marrëveshje për qendrën me Organizatën që duhet të aprovohet nga këshilli. Në pritje të lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, Organizata i kërkon qeverisë së re pritëse të japë, brenda kufijve të legjislacionit të brendshëm, përjashtime nga tatimet ose shpërblimet e paguara nga organizatat për punonjësit e saj, dhe mbi sendet e tyre pasurore, të ardhurat dhe pasuri të tjera të Organizatës.

5. Marrëveshja e qendrës është e pavarur nga kjo Marrëveshje. Megjithatë, ajo prishet:

a) me marrëveshje ndërmjet qeverisë pritëse dhe Organizatës;

b) në rastin e transferimit të qendrës së Organizatës nga vendi i qeverisë pritëse; ose

c) në rastin e pushimit të ekzistencës së Organizatës.

KAPITULLI VI
FINANCAT

Neni 18
Llogaritë financiare

1. Hapen:

a) llogaria administrative, që është një llogari e kontributit të vlerësuar;

b) llogaria e veçantë dhe Fondi i Partneritetit Bali, që janë llogari të kontributeve vullnetare; dhe

c) llogari të tjera që Këshilli i konsideron të përshtatshme dhe të nevojshme.

2. Këshilli, në pajtim me nenin 7, vendos rregulla financiare që sigurojnë menaxhim dhe administrim transparent të llogarive, duke përfshirë rregullat që përfshijnë shlyerjen e llogarive

me prishjen ose skadimin e Marrëveshjes.

3. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës dhe i raporton këshillit mbi administrimin e llogarive financiare.

Neni 19

Llogaria administrative

1. Shpenzimet e nevojshme për administrimin e kësaj Marrëveshjeje futen në llogarinë administrative dhe merren nga kontributet vjetore që paguhen nga anëtarët në pajtim me procedurat e tyre kushtetuese ose institucionale dhe vlerësohen në pajtim me paragrafët 4, 5 dhe 6 të këtij neni.

2. Llogaria administrative përfshin:

a) koston bazë administrative, si pagat dhe përfitimet, koston e instalimit, udhëtimet zyrtare; dhe

b) koston bazë operative, si ato në lidhje me komunikimin dhe kontaktin, takimet e ekspertëve që thirren nga Këshilli dhe përgatitjen dhe publikimin e studimeve dhe vlerësimeve në pajtim me nenet 24, 27 dhe 28 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Shpenzimet e delegacioneve të Këshillit, komiteteve dhe çdo organ tjetër të varur të Këshillit të përmendur në nenin 26, mbulohen nga anëtarët përkatës. Në rast se një anëtar kërkon shërbime të veçanta nga Organizata, Këshilli kërkon që anëtari të paguajë shpenzimet e këtyre shpenzimeve.

4. Para fundit të dyvjeçarit financiar, Këshilli aprovon buxhetin për llogarinë administrative të Organizatës për dyvjeçarin pasues dhe vlerëson kontributin e secilit anëtar për atë buxhet.

5. Kontributet për llogarinë administrative për çdo dyvjeçar financiar vlerësohen, si më poshtë:

a) Kostoja e përmendur në paragrafin 2(a) të këtij neni ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet anëtarëve prodhues dhe konsumatorë dhe vlerësohet në raport me numrin e votave të çdo anëtari që ka në votat e përgjithshme të grupit të anëtarit.

b) Kostoja e përmendur në paragrafin 2(b) të këtij neni ndahet ndërmjet anëtarëve në raportin: 20 për qind për prodhuesit dhe 80 për qind për konsumatorët dhe vlerësohet në raport me numrin e votave të çdo anëtari që ka në votat e përgjithshme të grupit të anëtarit.

c) Kostoja e përmendur në paragrafin 2(b) të këtij neni nuk kalon një të tretën e kostos së përmendur në paragrafin 2(a) të këtij neni. Këshilli, me konsensus, mund të vendosë të ndryshojë këtë limit për një dyvjeçar të caktuar financiar;

d) Këshilli mund të rishikojë si kontribuojnë llogaria administrative dhe llogaritë vullnetare për operimin efiçent dhe efektiv të Organizatës në kontekstin e vlerësimit të përmendur në nenin 33; dhe

e) Në vlerësimin e kontributeve, votat për secilin anëtar llogariten pa marrë parasysh pezullimin e të drejtave të votës së një anëtari ose ndonjë rishpërndarje të votave që rrjedh nga kjo.

6. Kontributi fillestar i një anëtari që futet në Organizatë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje vlerësohet nga Këshilli mbi bazën e numrit të votave që do të merren nga ai anëtar dhe të periudhës së mbetur në dyvjeçarin përkatës financiar, por vlerësimi i bërë për anëtarët e tjerë nga dyvjeçari përkatës financiar nuk ndryshohet nga kjo.

7. Kontributet në llogarinë administrative bëhen të kërkueshme në ditën e parë të çdo viti financiar. Kontributet e anëtarëve në lidhje me dyvjeçarin financiar në të cilin ata futen në Organizatë bëhen të kërkueshme në datën në të cilën ata bëhen anëtarë.

8. Nëse një anëtar nuk ka paguar plotësisht kontributin e tij në llogarinë administrative brenda katër muajve pasi bëhen të kërkueshme këto kontribute në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni, Drejtori Ekzekutiv kërkon që ai anëtar të bëjë pagesën sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse

ai anëtar ende nuk e ka paguar kontributin e tij brenda dy muajve pas një kërkese të tille, atij anëtari i kërkohet të thotë arsyet për pamundësinë e tij për të bërë pagesën. Nëse me kalimin e shtatë muajve nga data kur kontributi është i kërkueshëm, ai anëtar nuk ka paguar kontributin e tij, të drejtat e tij të votimit pezullohen deri në atë moment kur ai paguan kontributin e tij të plotë, përveç rasteve kur Këshilli, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, vendos ndryshe. Nëse një anëtar nuk ka paguar kontributin e tij plotësisht për dy vite të njëpasnjëshëm, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 30, ai anëtar bëhet i papërshtatshëm për të paraqitur propozime projekti dhe para-projekti për t'u shqyrtuar për financime sipas nenit 25, paragrafi 1.

9. Nëse një anëtar paguan kontributin e tij të plotë në llogarinë administrative brenda katër muajve pasi një kontribut i tillë bëhet i kërkueshëm në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni, kontributit të atij anëtari i bëhet një zbritje që vendoset nga këshilli sipas rregullave financiare të Organizatës.

10. Një anëtar, të drejtat e të cilit janë pezulluar në pajtim me paragrafin 8 të këtij neni, mbetet i detyruar të paguajë kontributin e tij.

Neni 20

Llogaria e veçantë

1. Llogaria e veçantë përbëhet nga dy nënllogari:

a) nënllogaria e programeve tematike; dhe

b) nënllogaria e projektit.

2. Burimet e mundshme për financimin e llogarisë së veçantë janë:

a) Fondi i Përbashkët për Mallrat;

b) institucionet financiare rajonale dhe ndërkombëtare;

c) kontributet vullnetare nga anëtarët; dhe

d) burime të tjera.

3. Këshilli vendos kritere dhe procedura për operimin transparent të llogarisë së veçantë. Këto procedura marrin parasysh nevojën për përfaqësim të balancuar ndërmjet anëtarëve, duke përfshirë anëtarët kontribuues, në operimin e nënllogarive të programeve tematike dhe nënllogarinë e projektit.

4. Qëllimi i nënllogarisë së programeve tematike është lehtësimi i kontributeve të paparashikuara për financimin e paraprojekteve, projekteve dhe aktiviteteve të aprovuara në pajtim me programet tematike të vendosura nga Këshilli mbi bazën e prioriteteve të politikave dhe projekteve të identifikuara në pajtim me nenet 24 dhe 25.

5. Donatorët mund të japin kontributet e tyre për programet specifike tematike ose mund t'i kërkojnë Drejtorit Ekzekutiv të bëjë propozime për dhënien e kontributeve të tyre.

6. Drejtori Ekzekutiv i raporton rregullisht Këshillit mbi dhënien dhe shpenzimet e fondeve brenda nënllogarisë së programeve tematike dhe mbi zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e paraprojekteve, projekteve dhe aktiviteteve dhe nevojave financiare për zbatimin e suksesshëm të programeve tematike.

7. Qëllimi i nënllogarisë së projektit është të lehtësojë kontributet e parashikuara për financimin e para-projekteve, projekteve dhe aktiviteteve të aprovuara në pajtim me nenet 24 dhe 25.

8. Kontributet e parashikuara në nënllogarinë e projektit përdoren vetëm për paraprojektet, projektet dhe aktivitetet për të cilat ato janë destinuar, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga donatori në konsultim me Drejtorin Ekzekutiv. Pas përfundimit ose ndërprerjes së një para-projekti, projekti ose aktiviteti, përdorimi i çdo fondi të mbetur vendoset nga donatori.

9. Për të siguruar parashikueshmërinë e nevojshme të fondeve për llogarinë e veçantë, duke marrë parasysh natyrën vullnetare të kontributeve, anëtarët përpiqen ta rimbushin atë për të arritur nivelin e përshtatshëm të burimeve për të realizuar plotësisht para-projektet, projektet dhe aktivitetet e aprovuara nga Këshilli.

10. Të gjitha shumat e marra që u përkasin paraprojekteve, projekteve dhe aktiviteteve specifike në nënllogarinë e projektit ose nënllogarinë e programeve tematike futen në nënllogarinë përkatëse. Të gjitha shpenzimet e kryera në këto paraprojekte, projekte ose aktivitete, duke përfshirë shpërblimin dhe shpenzimet e udhëtimit të konsulentëve dhe ekspertëve i ngarkohen të njëjtës nënllogari.

11. Asnjë anëtar nuk është përgjegjës për shkak të anëtarësisë së tij në Organizatë për ndonjë përgjegjësi që rrjedh nga një veprim i një anëtari ose subjekti tjetër në lidhje me paraprojektet, projektet dhe aktivitetet.

12. Drejtori Ekzekutiv jep asistencë në zhvillimin e propozimeve për paraprojektet, projektet dhe aktivitetet në pajtim me nenet 24 dhe 25 dhe përpiqet të kërkojë, me ato kushte dhe terma që mund të caktojë këshilli, financim të përshtatshëm dhe të sigurt për para-projektet, projektet dhe aktivitetet e aprovuara.

Neni 21
Fondi i Partneritetit Bali

1. Themelohet një fond për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve që prodhojnë lëndë druri tropikale për të asistuar anëtarët prodhues për të bërë investimet e nevojshme për arritur objektivat e nenit 1(d) të kësaj Marrëveshjeje.

2. Fondi përbëhet nga:

a) kontributet nga anëtarët donatorë;

b) pesëdhjetë për qind e të ardhurave të fituara si rezultat i aktiviteteve në lidhje me llogarinë e veçantë;

c) Burimet nga burime të tjera private dhe publike që Organizata mund të pranojë në pajtim me rregullat e saj financiare; dhe

d) Burime të tjera të aprovuara nga Këshilli.

3. Burimet e Fondit jepen nga Këshilli vetëm për paraprojektet dhe projektet për qëllimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe që janë aprovuar në pajtim me nenet 24 dhe 25.

4. Në dhënien e burimeve të Fondit, këshilli vendos kritere dhe prioritete për përdorimin e Fondit, duke marrë parasysh:

a) nevojat e anëtarëve për asistencë në realizimin e eksporteve të lëndës drusore tropikale dhe produkteve tropikale nga burimet e menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme;

b) nevojat e anëtarëve për të vendosur dhe menaxhuar programet e rëndësishme të konservimit në pyjet që prodhojnë lëndë druri; dhe

c) nevojat e anëtarëve për të zbatuar programe të qëndrueshme për menaxhimin e pyjeve.

5. Drejtori Ekzekutiv jep asistencë në zhvillimin e propozimeve për projekte në pajtim me nenin 25 dhe përpiqet të kërkojë, me ato terma dhe kushte që mund të vendosë këshilli, financim të përshtatshëm dhe sigurt për projektet e aprovuara nga këshilli.

6. Anëtarët përpiqen të rimbushin fondin e Partneritetit Bali deri tek një nivel i përshtatshëm për të arritur objektivat e Fondit.

7. Këshilli shqyrton në intervale të rregullta përshtatshmërinë e burimeve të përshtatshme për Fondin dhe përpiqet të përftojë burime shtesë që kërkohen për anëtarët prodhues për arritjen e qëllimit të Fondit.

Neni 22
Format e pagesës

1. Kontributet financiare në llogaritë e hapura sipas nenit 18 janë të pagueshme në monedha lirisht të konvertueshme dhe përjashtohen nga kufizimet e shkëmbimit të valutës së huaj.

2. Këshilli mund të vendosë gjithashtu të pranojë forma të tjera të kontributeve për në

llogaritë e hapura sipas nenit 18, të ndryshme nga llogaria administrative, duke përfshirë pajisjet dhe personelin shkencor dhe teknik, për të përmbushur kërkesat e projekteve të aprovuara.

Neni 23
Auditimi dhe publikimi i llogarive

1. Këshilli cakton auditë të pavarur për qëllimin e auditimit të llogarive të Organizatës.

2. Pasqyrat e audituara në mënyrë të pavarur të llogarive të hapura sipas Nenit 18 u ofrohen anëtarëve sa më shpejt të jetë e mundur pas mbylljes së çdo viti financiar, por jo më vonë se gjashtë muaj pas asaj date dhe shqyrtohen për aprovim nga Këshilli në sesionin tjetër të tij, sipas rastit. Një përmbledhje e llogarive dhe bilancit të audituar pas kësaj publikohet më pas.

KAPITULLI VII
AKTIVITETET OPERACIONALE

Neni 24
Puna politike e Organizatës

1. Me qëllim që të arrihen objektivat e përcaktuara në nenin 1, Organizata ndërmerr punë politike dhe aktivitete projekti në një mënyrë të integruar.

2. Puna politike e Organizatës duhet të kontribuojë për arritjen sa më të plotë të objektivave të kësaj Marrëveshjeje për anëtarët e ITTO.

3. Këshilli vendos rregullisht një plan veprimi për të drejtuar aktivitetet e politikave dhe identifikuar prioritetet dhe programet tematike të përmendura në nenin 20, paragrafin 4, të kësaj Marrëveshjeje. Prioritetet e identifikuara në planin e veprimit reflektohen në programet e punës të aprovuara nga Këshilli. Aktivitetet e politikës mund të përfshijnë zhvillimin dhe përgatitjen e udhëzimeve, manualeve, studimeve, raporteve, komunikimit bazë dhe mjetet e kontaktit dhe punë të ngjashme të identifikuara në planin e veprimit të Organizatës.

Neni 25
Aktivitetet e projektit të Organizatës

1. Anëtarët dhe Drejtori Ekzekutiv mund të paraqesin propozime për paraprojekte dhe projekte që kontribuojnë në arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje dhe një ose më shumë të sferave prioritare për punën ose programet tematike të identifikuara në planin e veprimit të aprovuara nga Këshilli në pajtim me nenin 24.

2. Këshilli vendos kritere për aprovimin e projekteve dhe paraprojekteve duke marrë parasysh, ndër të tjera, lidhjen e tyre me objektivat e kësaj Marrëveshjeje dhe sferat prioritare për punën ose programet tematike, efektet e tyre ambientaliste dhe sociale, raportin e tyre me programet dhe strategjitë kombëtare për pyjet, efektivitetin e tyre për koston, nevojat teknike dhe rajonale, nevojën për mënjanimin e publikimit të përpjekjeve, dhe nevojën për të përfshirë mësimet e nxjerra.

3. Këshilli vendos një grafik dhe procedurë për paraqitjen, vlerësimin, aprovimin dhe caktimin e prioriteteve për paraprojektet dhe projektet që kërkojnë financim nga Organizata, si dhe për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tyre.

4. Drejtori Ekzekutiv mund të pezullojë disbursimin e fondeve të Organizatës për një paraprojekt ose projekt nëse ata përdoren në kundërshtim me dokumentin e projektit ose në rastet e mashtrimit, shpërdorimit, neglizhencës ose keqmenaxhimit. Drejtori Ekzekutiv i paraqet Këshillit në seksionin e ardhshëm një raport për shqyrtim. Këshilli merr masat e duhura.

5. Këshilli, sipas kritereve të aprovuara, mund të vendosë limite për numrin e projekteve

dhe paraprojekteve që një anëtar ose Drejtori Ekzekutiv mund të paraqesë në një cikël të caktuar projektesh. këshilli mund të marrë gjithashtu masa të përshtatshme, duke pezulluar ose ndërprerë sponsorizimin e tij për çdo paraprojekt ose projekt, pas raportit të Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 26
Komitetet dhe organet e varësisë

1. Organet e mëposhtme ngrihen si komitete të Organizatës që mund të jenë të hapura për të gjithë anëtarët:

a) Komiteti për Industrinë e Pyjeve;

b) Komiteti i Ekonomisë, Statistikave dhe Tregjeve;

c) Komiteti për Ripyllëzimin dhe Menaxhimin e Pyjeve; dhe

d) Komiteti për Financën dhe Administratën.

2. Këshilli, me votë të veçantë në pajtim me nenin 12, themelon ose shpërndan komitete dhe organe varësie, sipas rastit.

3. Këshilli përcakton funksionimin dhe objektin e punës së komiteteve dhe organeve të tjera të varësisë. Komitetet dhe organet e tjera të varësisë janë përgjegjës dhe punojnë nën autoritetin e Këshillit.

KAPITULLI VIII
STATISTIKAT, STUDIMET DHE INFORMACIONI

Neni 27
Statistikat, studimet dhe informacioni

1. Këshilli autorizon Drejtorin Ekzekutiv për të krijuar dhe ruajtur raporte të ngushta me organizatat ndërqeveritare, qeveritare dhe joqeveritare me qëllim që të ndihmohet sigurimi i disponueshmërisë së informacionit dhe të dhënave të fundit dhe të besueshme, duke përfshirë ato për prodhimin dhe tregtinë me lëndë drusore tropikale, tendencat dhe mospërputhjet e të dhënave, si dhe informacionin përkatës mbi lëndën drusore jo-tropikale dhe mbi menaxhimin e pyjeve që prodhojnë lëndë drusore. Siç çmohet e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Organizata, në bashkëpunim me këto organizata, përpilon, bashkon, analizon dhe publikon informacionin e tillë.

2. Organizata kontribuon në përpjekjet për të standardizuar dhe harmonizuar raportimin ndërkombëtar mbi çështjet në lidhje me pyjet, duke mënjanuar mbivendosjen dhe publikimin e mbledhjes së të dhënave nga organizata të ndryshme.

3. Anëtarët, në masën më të gjerë të mundshme, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, japin brenda afateve të caktuara nga Drejtori Ekzekutiv, statistika dhe informacione mbi lëndën drusore, tregtinë e saj dhe aktivitetet që synojnë arritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve që prodhojnë lëndë drusore, si dhe informacion tjetër të rëndësishëm që kërkohet nga Këshilli. Këshilli vendos mbi tipin e informacionit që duhet të jepet sipas këtij paragrafi dhe mbi formatin që ai duhet të jepet.

4. Me kërkesë ose kur është e nevojshme, Këshilli përpiqet të rrisë kapacitetin teknik të vendeve anëtare, veçanërisht në vendet anëtare në zhvillim, që të përmbushin kërkesat për statistika dhe raportimin sipas kësaj Marrëveshjeje.

5. Nëse një anëtar nuk ka paraqitur për dy vite të njëpasnjëshme statistikat dhe informacionin e kërkuar sipas paragrafit 3 dhe nuk ka kërkuar asistencën e Drejtorit Ekzekutiv, Drejtori Ekzekutiv fillimisht kërkon një shpjegim nga ai shtet brenda një afati të caktuar. Në rast se nuk jepet shpjegim i pranueshëm, Këshilli merr ato veprime që i konsideron të përshtatshme.

6. Këshilli merr masa për të realizuar çdo studim përkatës të tendencave dhe të

problemeve afatshkurtra dhe afatgjata të tregjeve ndërkombëtarë të lëndës drusore dhe të progresit drejt arritjes së menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve të prodhimit të lëndës drusore.

Neni 28
Raporti vjetor dhe rishikimi dyvjeçar

1. Këshilli publikon një raport vjetor mbi aktivitetet e tij dhe çdo informacion tjetër që ai e konsideron të përshtatshëm.

2. Këshilli rishikon dhe vlerëson në çdo dy vjet:

a) gjendjen ndërkombëtare të lëndës drusore; dhe

b) faktorë, çështje dhe zhvillime të tjera që konsiderohen të rëndësishme për arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

3. Rishikimi realizohet duke marrë parasysh:

a) informacionin e dhënë nga anëtarët në lidhje me prodhimin, tregtinë, furnizimin, stoqet, konsumin dhe çmimet kombëtare të lëndës drusore;

b) të dhëna të tjera statistikore dhe tregues specifikë të dhëna nga anëtarët siç kërkohet nga Këshilli;

c) Informacionin e dhënë nga anëtarët mbi përparimin e tyre drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve të tyre për prodhimin e lëndës drusore;

d) informacion tjetër përkatës që mund t'i ofrohet Këshillit drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatave në sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe organizatave ndërqeveritare, qeveritare dhe joqeveritare; dhe

e) informacionin e dhënë nga anëtarët mbi përparimin e tyre drejt vendosjes së mekanizmave të kontrollit dhe informimit në lidhje me vjeljen e paligjshme dhe tregtinë e paligjshme me lëndë drusore tropikale dhe produkte pyjesh jodrusore.

4. Këshilli mund të nxisë shkëmbimin e mendimeve ndërmjet vendeve anëtare në lidhje me:

a) statusin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve prodhuese të lëndës drusore dhe çështjet përkatëse në vendet anëtare; dhe

b) fluksin e burimeve dhe kërkesave në lidhje me objektivat, kriteret dhe udhëzimet e caktuara nga Organizata.

5. Me kërkesë, Këshilli përpiqet të rrisë kapacitetin teknik të vendeve anëtare, veçanërisht në vendet anëtare në zhvillim për të marrë të dhënat e nevojshme për shkëmbimin e informacionit të duhur, duke përfshirë dhënien e burimeve për trajnimin dhe mjetet për anëtarët.

6. Rezultatet e rishikimit përfshihen në raportet përkatëse të seksioneve të Këshillit.

KAPITULLI IX
TË NDRYSHME

Neni 29
Detyrime të përgjithshme të anëtarëve

1. Anëtarët, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, bëjnë përpjekjet e tyre maksimale dhe bashkëpunojnë për të nxitur arritjen e objektivave dhe mënjanojnë çdo veprim në kundërshtim me to.

2. Anëtarët marrin përsipër të pranojnë dhe zbatojnë vendimet e Këshillit sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk zbatojnë masat që do të kishin efekt në kufizimin ose do të binin ndesh me to.

Neni 30
Lirimi nga detyrimet

1. Nëse për shkak të rrethanave të veçanta ose të një emergjence apo force madhore, që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje, është e nevojshme që Këshilli, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, mund të lirojë një anëtar nga një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse ai bindet nga një shpjegim i atij anëtari në lidhje me shkaqet se pse ai detyrim nuk mund të përmbushet.

2. Këshilli, në dhënien e lirimit një anëtari në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, deklaron shprehimisht termat dhe kushtet në bazë të të cilave dhe periudhën për të cilën anëtari është i lirë nga ky detyrim dhe shkaqet për të cilat jepet lirimi.

Neni 31
Ankesat dhe mosmarrëveshjet

Çdo anëtar mund t'i paraqesë Këshillit një ankesë që asnjë anëtar nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Vendimet e Këshillit për këto çështje merren me konsensus, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, dhe janë përfundimtarë dhe të detyrueshëm.

Neni 32
Masat e diferencuara dhe korrigjuese dhe masat e veçanta

1. Anëtarët konsumatorë që janë vende në zhvillim interesat e të cilëve ndikohen negativisht me masat e marra sipas kësaj Marrëveshjeje mund të bëjnë kërkesë në Këshill për masa të përshtatshme të diferencuara dhe korrigjuese. Këshilli shqyrton marrjen e masave të përshtatshme në pajtim me seksionin III, paragrafët 3 dhe 4, të Rezolutës 93(IV) të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi tregtinë dhe zhvillimin.

2. Anëtarët në kategorinë e vendeve më pak të zhvilluara sipas përkufizimit nga Kombet e Bashkuara mund të bëjnë kërkesë në Këshill për masa të veçanta në pajtim me Seksionin III, paragrafi 4, të Rezolutës 93(IV) dhe me paragrafët 56 dhe 57 të Deklaratës së Parisit dhe Programit të Veprimit për Vendet më Pak të Zhvilluara për vitet '90.

Neni 33
Rishikimi

Këshilli mund të vlerësojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë objektivat dhe mekanizmat financiarë, pesë vjet pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 34
Mosdiskriminimi

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk autorizon përdorimin e masave për kufizimin ose ndalimin e tregtisë ndërkombëtare, dhe veçanërisht në lidhje me importet, dhe përdorimin e lëndës drusore dhe produkteve të lëndës drusore.

KAPITULLI X
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 35
Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara caktohet si depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 36
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi dhe aprovimi

1. Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim, në Selinë e Kombeve të Bashkuara nga data 3 prill 2006 deri një muaj pas datës e hyrjes së saj në fuqi, nga Qeveritë e ftuara në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Bisedimet për një Marrëveshje Pasuese të Marrëveshjes Ndërkombëtarë të Lëndës Drusore Tropikale, 1994.

2. Çdo Qeveri e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund:

a) në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, të deklarojë që ky nënshkrim shpreh pëlqimin e saj për t'iu nënshtruar kësaj Marrëveshjeje (nënshkrim i përfundimtar); ose

b) pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, të ratifikojë, pranojë ose aprovojë atë nëpërmjet depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim tek depozitari.

3. Me nënshkrimin dhe ratifikimin, pranimin ose aprovimin, apo aderimin ose zbatimin e përkohshëm, Komuniteti Europian ose çdo organizatë ndërqeveritare e përmendur në nenin 5, paragrafi 1, depoziton një deklaratë të lëshuar nga autoriteti përkatës i kësaj organizate që përcakton natyrën dhe masën e kompetencës së tij për çështjet e rregulluara nga kjo Marrëveshje dhe informon depozitarin për çdo ndryshim të mëvonshëm thelbësor në këtë kompetencë. Nëse një organizatë e tillë deklaron kompetencë ekskluzive për të gjitha çështjet e rregulluara nga kjo Marrëveshje, Shtetet anëtare të kësaj organizate nuk ndërmarrin veprimet sipas nenit 36, paragrafi 2, nenit 37 dhe nenit 38, ose ndërmarrin veprime sipas nenit 41 ose tërheqin njoftimin e zbatimit të përkohshëm sipas nenit 38.

Neni 37
Aderimi

1. Kjo Marrëveshje është e hapur për aderim nga qeveritë sipas kushteve të përcaktuara nga Këshilli, që përfshin një afat kohor për depozitimin e instrumenteve të aderimit. Këto kushte transmetohen nga Këshilli tek depozitari. Këshilli, megjithatë, mund të japë zgjatje të afateve për qeveritë që nuk janë në gjendje të aderojnë brenda afatit kohor të caktuar në kushtet e aderimit.

2. Aderimi hyn në fuqi nëpërmjet depozitimit të instrumentit të aderimit tek depozitari.

Neni 38
Njoftimi i zbatimit të përkohshëm

Një qeveri nënshkruese që synon të ratifikojë, pranojë ose aprovojë këtë Marrëveshje ose një qeveri për të cilën Këshilli ka vendosur kushte për aderim por që nuk ka qenë në gjendje të depozitojë instrumentet e saj, në çdo kohë, mund të njoftojë depozitarin që ai do të zbatojë këtë Marrëveshje përkohësisht në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj, kur ajo hyn në fuqi në pajtim me nenin 39 ose, nëse është në fuqi, në një datë të caktuar.

Neni 39
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi përfundimisht më 1 shkurt 2008 ose në një datë të mëvonshme, nëse 12 qeveri të prodhuesve që kanë të paktën 60 për qind të të gjitha votave sipas parashikimit në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje dhe 10 qeveri të konsumatorëve sipas renditjes në aneksin B dhe që kanë 60 për qind të volumit të përgjithshëm të importit të lëndës drusore tropikale në vitin e referencës 2005 kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht ose e kanë ratifikuar, pranuar ose aprovuar atë në pajtim me nenin 36, paragrafi 2, ose nenin 37.

2. Nëse kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi përfundimisht më 1 shkurt 2008, ajo hyn në fuqi përkohësisht në atë datë ose në çdo datë brenda gjashtë muajve më pas, nëse 10 qeveri të prodhuesve që kanë të paktën 50 për qind të të gjithë votave sipas parashikimit në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje dhe shtatë qeveri të konsumatorëve sipas renditjes në aneksin B dhe që kanë 50 për qind të volumit të përgjithshëm të importit të lëndës drusore tropikale në vitin e referencës 2005, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht apo kanë ratifikuar, pranuar ose aprovuar atë në pajtim me nenin 36, paragrafi 2, ose kanë njoftuar depozitarin në pajtim me nenin 38 që ato do të zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht.

3. Nëse kërkesat për hyrjen në fuqi sipas paragrafit 1 ose paragrafit 2 të këtij neni nuk janë përmbushur më 1 shtator 2008, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara fton qeveritë që kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht ose që e kanë ratifikuar, pranuar apo aprovuar atë në pajtim me nenin 36, paragrafi 2, ose kanë njoftuar depozitarin që ato do të zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht, të mblidhen më momentin më të parë të mundshëm për të vendosur nëse do t'i japin fuqi kësaj Marrëveshjeje përkohësisht apo përfundimisht ndërmjet tyre, plotësisht apo pjesërisht. Qeveritë që vendosin t'i japin fuqi të përkohshme kësaj Marrëveshjeje ndërmjet tyre mund të mblidhen herë pas here për të rishikuar gjendjen dhe për të vendosur nëse Marrëveshja do të hyjë përfundimisht në fuqi ndërmjet tyre.

4. Për çdo qeveri që nuk ka njoftuar depozitarin sipas nenit 38 që do të zbatojë këtë marrëveshje përkohësisht dhe që depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e këtij depozitimi.

5. Drejtori Ekzekutiv i Organizatës mbledh këshillin sa më shpejt të jetë ë mundur pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 40
Ndryshimet

1. Këshilli, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, mund t'u rekomandojë anëtarëve një ndryshim të kësaj Marrëveshjeje.

2. Këshilli cakton një datë në të cilën anëtarët njoftojnë depozitarin për pranimin e ndryshimit.

3. Një ndryshim hyn në fuqi 90 ditë pasi depozitari të ketë marrë njoftimet e pranimit nga anëtarët që përbëjnë të paktën dy të tretat e anëtarëve prodhues dhe që kanë të paktën 75 për qind të votave të anëtarëve prodhues dhe nga anëtarët që përbëjnë të paktën dy të tretat e anëtarëve konsumatorë dhe që kanë të paktën 75 për qind e votave të anëtarëve konsumatorë.

4. Pasi depozitari të informojë Këshillin që kërkesat për hyrjen në fuqi të ndryshimit janë plotësuar dhe pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni në lidhje me datën e caktuar nga Këshilli, një anëtar mund të njoftojë depozitarin për pranimin e tij të ndryshimit, me kusht që një njoftim i tillë të bëhet para hyrjes në fuqi të ndryshimit.

5. Çdo anëtar që nuk ka njoftuar pranimin e një ndryshimi nga data në të cilën një

ndryshim i tillë hyn në fuqi, pushon së qeni palë në këtë Marrëveshje nga ajo datë, përveç rasteve kur ky anëtar ka bindur Këshillin që pranimi i tij nuk mund të merrej në kohë për shkak të vështirësive në përfundimin e procedurave kushtetuese dhe institucionale dhe Këshilli vendos për të zgjatur për atë anëtar periudhën e pranimit të ndryshimit. Ky anëtar nuk i nënshtrohet ndryshimit para se ai të ketë njoftuar pranimin e tij.

6. Nëse kërkesat për hyrjen në fuqi të ndryshimit nuk janë plotësuar në datën e caktuar nga Këshilli në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, ndryshimi konsiderohet i tërhequr.

Neni 41

Tërheqja

1. Një anëtar mund të tërhiqet nga Marrëveshja në çdo kohë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes nëpërmjet njoftimit me shkrim për tërheqjen drejtuar depozitarit. Ai anëtar informon njëkohësisht Këshillin për veprimin që ka ndërmarrë.

2. Tërheqja hyn në fuqi 90 ditë pasi njoftimi të jetë marrë nga depozitari.

3. Detyrimet financiare kundrejt Organizatës të shkaktuara nga një anëtar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk ndërpriten me tërheqjen e tij.

Neni 42

Përjashtimi

Nëse Këshilli vendos që një anëtar është në shkelje të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe vendos që kjo shkelje cenon rëndë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ai, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, e përjashton atë anëtar nga Marrëveshja. Këshilli njofton për këtë menjëherë depozitarin. Gjashtë muaj pas datës së vendimit të Këshillit, ai anëtar pushon së qeni palë në këtë Marrëveshje.

Neni 43

Shlyerja e llogarive me anëtarët që tërhiqen ose përjashtohen ose anëtarët që nuk janë në gjende të pranojnë një ndryshim

1. Këshilli vendos për të gjitha shlyerjet e llogarive me një anëtar që pushon se qeni palë në këtë Marrëveshje për shkak të:

a) mospranimit të një ndryshimi të kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 40;

b) tërheqjes nga kjo Marrëveshje sipas nenit 41; ose

c) përjashtimit nga kjo Marrëveshje sipas nenit 42.

2. Këshilli ruan çdo vlerësim ose kontribut të paguar në llogaritë financiare sipas nenit 18 nga një anëtar që pushon se qeni palë në këtë Marrëveshje.

3. Një anëtar që ka pushuar së qeni palë në këtë Marrëveshje nuk ka të drejtën për ndonjë pjesë në produktet e likuidimit ose sende të tjera pasurore të Organizatës. Një anëtar i tillë nuk është i detyruar për ndonjë pagesë apo pjesë deficiti, sipas rastit, të Organizatës me prishjen e Marrëveshjes.

Neni 44

Kohëzgjatja, zgjatja dhe prishja

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë kohore prej 10 vjetësh pas hyrjes së saj në fuqi, përveç kur Këshilli, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, vendos të zgjatë, rinegociojë ose prishë atë në pajtim me dispozitat e këtij neni.

2. Këshilli, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, mund të vendosë të zgjasë këtë Marrëveshje për dy periudha, një periudhë fillestare pesëvjeçare dhe një tjetër shtesë trevjeçare.

3. Nëse, para skadimit të periudhës 10-vjeçare të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ose para skadimit të një periudhe zgjatjeje të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, sipas rastit, Marrëveshja e re që zëvendëson këtë Marrëveshje është biseduar por nuk ka hyrë ende në fuqi përfundimisht apo përkohësisht. Këshilli, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, mund të zgjasë këtë Marrëveshje deri në hyrjen në fuqi përfundimtare apo të përkohshme të Marrëveshjes së re.

4. Nëse Marrëveshja e re negociohet dhe hyn në fuqi gjatë një periudhe zgjatjeje të kësaj Marrëveshjeje sipas paragrafit 2 ose paragrafit 3 të këtij neni, kjo Marrëveshje, në formën që është zgjatur, pushon së qeni në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së re.

5. Këshilli në çdo kohë, me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, mund të vendosë të prishë këtë Marrëveshje me fuqi nga data që ai mund të caktojë.

6. Pavarësisht prishjes së kësaj Marrëveshjeje, Këshilli vazhdon të mbetet në fuqi për një periudhë që nuk kalon 18 muaj për të kryer likuidimin e Organizatës, duke përfshirë shlyerjen e llogarive, dhe në pajtim me vendimet përkatëse që merren me votim të veçantë në pajtim me nenin 12, gjatë kësaj periudhe ka ato kompetenca dhe funksione që mund të jenë të nevojshme për këto qëllime.

7. Këshilli njofton depozitarin për çdo vendim të marrë në bazë të këtij neni.

Neni 45
Rezervat

Rezervat nuk mund të bëhen në lidhje me një dispozitë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 46
Dispozita plotësuese dhe të përkohshme

1. Kjo Marrëveshje është pasuese e Marrëveshjes ndërkombëtare për lëndën drusore tropikale të vitit 1994.

2. Të gjitha aktet në emër të kësaj Organizate ose të ndonjë prej organeve të saj sipas Marrëveshjes ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale të vitit 1983, dhe/ose sipas Marrëveshjes ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale të vitit 1994, që janë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe termat e të cilëve nuk parashikojnë skadimin në atë datë mbeten në fuqi përveç rasteve kur ndryshohen në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Gjenevë, më 27 janar 2006, tekstet e kësaj Marrëveshjeje në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike.

ANEKSI A

LISTA E QEVERIVE QË KANË NDJEKUR KONFERENCËN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BISEDIMIN E NJË MARRËVESHJEJE PASUESE TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE TË LËNDËS DRUSORE TROPIKALE, 1994 QË JANË ANËTARËT PRODHUES POTENCIALË SIPAS PARASHIKIMIT NË NENIN 2 (PËRKUFIZIME) DHE CAKTIMI TREGUES I VOTAVE SIPAS NENIT 10 (SHPËRNDARJA E VOTAVE)

Anëtarët	Votat e përgjithshme
Afrikë	249
Angolë	18
Benin	17
Kamerun*	18
Republika e Afrikës Qendrore*	18
Bregu i Fildishtë*	18
Republika Demokratike e Kongos*	18
Gabon*	18
Gana*	18
Liberi*	18
Madagaskar	18
Nigeri*	18
Republika e Kongos*	18
Ruanda	17
Togo*	17
Azi – Paqësor	389
Kamboxhia*	15
Fixhi*	14
Indi*	22
Indonezi*	131
Malaizi*	105
Mianmar*	33
Papua Guinea e Re *	25
Filipine*	14
Tailandë*	16
Vanuatu*	14
Amerika Latine dhe Karaibet	362
Barbados	7
Bolivi*	19
Brazil*	157
Kolombi*	19
Kosta Rika	7
Republika Domenikane	7
Ekuador*	11
Guatemala*	8
Guajana*	12

Haiti	7
Honduras*	8
Meksikë*	15
Nikaragua	8
Panama*	8
Paraguaj	10
Peru*	24
Surinam*	10
Trinidad & Tobago*	7
Venezuela*	18
TOTALI:	1 000

* Anëtarë të Marrëveshjes ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale, 1994

ANEKSI B

LISTA E QEVERIVE QË KANË NDJEKUR KONFERENCËN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BISEDIMIN E NJË MARRËVESHJEJE PASUESE TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE TË LËNDËS DRUSORE TROPIKALE, 1994 QË JANË ANËTARË KONSUMATORË POTENCIALË SIPAS PARASHIKIMIT NË NENIN 2 (PËRKUFIZIME)

Shqipëri
Algjeri
Australi*
Kanada*
Kinë*
Egjipt*
Komuniteti Europian*
Austri*
Belgjikë*
Republika Çeke
Estoni
Finlandë*
Francë*
Gjermani*
Greqi*
Irlandë*
Itali*
Lituani
Luksemburg*
Holandë*
Poloni
Portugali*
Sllovaki
Spanjë*
Suedi*
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe
Irlanda e Veriut*
Iran (Republika Islamike e)
Irak

Japoni*
Lesoto
Jamahiria Libiane Arabe
Marok

Nepal*
Zelanda e Re*
Norvegji*
Republika e Koresë*
Zvicër*
Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

* Anëtarë të Marrëveshjes ndërkombëtare të lëndës drusore tropikale, 1994